

SHOQATA E KONTABILISTËVE DHE FINANCIERËVE TË SHQIPËRISË

RREGULLORE  
**PER RREGULLAT E BRENDSHME PËR KUALIFIKIMIN E VIJUESHËM  
PROFESIONAL**

Funksioni propozues	<b>Këshilli Drejtues</b>
Funksioni aprovues	<b>Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve</b>
Data e aprovimit	<b>24.10.2020</b>

## **Neni 1** **Qëllimi**

1. Shoqata e Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë, në përmbushje të misionit të vet dhe të detyrimeve ligjore e rregullatorë, harton **rregulla të brendshme për kualifikimin e vijueshëm profesional** të anëtarëve.
2. Kjo rregullore përcakton kushtet e organizimit dhe monitorimit të Kualifikimin e Vijueshëm Profesional (KVP) nga SH.K.F.SH., si dhe kërkesat që duhet të përmbushin anëtarët persona fizikë për t'u zhvilluar profesionalisht dhe për të mbajtur aftësinë profesionale të nevojshme që garantojnë shërbime me cilësi të lartë për klientët, punëdhënësit dhe palët e tjera dhe rrisin besimin e publikut në profesion.
3. Në këtë rregullore parashikohen mënyrat dhe format e kryerjes së trajnimit, të monitorimit të veprimtarive të kualifikimit të vijueshëm, njohja dhe ekuivalentimi i formave të ndryshme të trajnimit, që realizohen nga palë të treta.
4. Kjo rregullore përcakton procedurat e formimit, organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Kualifikimit të Vijueshëm të SH.K.F.SH dhe përgjegjësitë e anëtarëve të këtij Komisioni.

## **Neni 2** **Baza ligjore dhe rregullatore**

1. Kjo rregullore është bazuar në nenin 52 të ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar (në vijim “Ligji Për Auditimin”, dhe nenin 4 dhe 5 të Rregullores Nr. 9, datë 27.02.2019 “Për rregullimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të profesionit të kontabilistit të miratuar dhe organizatave të tyre profesionale” (në vijim “Rregullore Nr. 9”).
2. Kjo rregullore miratohet nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

## **Neni 3** **Shkurtime dhe përkufizime**

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë atë kuptim që përcaktohet në Ligjin Për Auditimin dhe Statutin e Shoqatës.
2. Pa kundërshtuar pikën 1 më sipër, shkurtimeve e përdorura në këtë rregullore kanë këto kuptime:

**KMA – Kontabilist i Miratuar Aktiv** (ushtrues i profesionit), i cili është personi fizik, profesionist i lirë, i regjistruar në regjistrin e njëres prej organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar, që kontraktohet nga personi juridik për të kryer shërbime të kontabilitetit. Ai mund të kryejë edhe shërbime të tjera, të cilat nuk bien në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

**KMJ – Kontabilist i Miratuar Jo-aktiv (jo ushtrues i profesionit)**, është person, i regjistruar në regjistrin e njëres prej organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar, i pezulluar me kërkesën e tij nga organizata përkatëse për kryerjen e shërbimeve të kontabilitetit.

**Shërbimet e Kontabilitetit** janë shërbimet e mbajtjes dhe përgatitjes së librave kontabël, fiskalë dhe të pagave, të kontrollit dhe verifikimit të dokumentacionit kontabël, vlerësimet dhe analizat e kostos dhe kontabilitetit të drejtimit, vlerësimit dhe zbatimit të procedurave kontabël të përgatitjes së pasqyrave financiare, analiza financiare dhe këshillime përkatëse, si dhe shërbime të tjera të ngjashme.

**KVP –Kualifikim i vijueshëm profesional** është procesi i edukimit të detyrueshëm që çdo KM duhet të kryejë çdo vit në përputhje me këtë rregullore dhe ligjin Nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

“**KVP të verifikueshme**”, është aktiviteti i të mësuarit që mund për të verifikohet objektivisht nga strukturat kompetente dhe për të cilat Komisioni i Kualifikimit mund të lëshojë dëshmi dhe certifikata, të cilat vërtetojnë kryerjen e KVP-së përkatëse.

“**KVP të paverifikueshme**” janë aktivitetet e pavarura dhe joformale, ndjekja apo përfundimi i të cilave nuk mund të verifikohet objektivisht nga strukturat kompetente, si për shembull, leximi/studimi artikujve teknikë ose profesionalë, ndjekja e debateve dhe diskutimeve kolegjiale, që stimulojnë të mësuarit dhe edukimin profesional.

#### Neni 4

#### Krijimi dhe përbërja e Komisionit të Kualifikimit të Vijueshëm

1. Shoqata krijon Komisionin e Kualifikimit të Vijueshëm si strukturë e posaçme përgjegjës për hartimin e programeve, kurseve, trajnimeve dhe aktiviteteve të tjera të kualifikimit të vijueshëm profesional të KM-ve.

2. Komisioni i Kualifikimit përbëhet nga katër anëtarë të Shoqatës, të cilët emërohen nga Këshilli Drejtues i Shoqatës për një periudhë katërvjeçare. Këshilli Drejtues emëron si Kryetar të Komitetit njërin nga anëtarët. Anëtarët e Komisionit të Kualifikimit të Vijueshëm mund të jenë gjithashtu anëtarë të Këshillit Drejtues.
3. Komisioni i Kualifikimit është strukturë në varësi të Këshillit Drejtues të SH.K.F.SH. dhe që vepron në përputhje me parashikimet në këtë rregullore.

### **Neni 5**

#### **Përgjegjësitë e Komisionit të Kualifikimit të Vijueshëm**

1. Komisioni i Kualifikimit të Vijueshëm është përgjegjës për:
  - a) Hartimin e programeve dhe aktiviteteve të kualifikimit të vijueshëm profesional;
  - b) Përzgjedhjen dhe mbikëqyrjen e personave që drejtojnë mësimdhënien e programeve dhe aktiviteteve në kuadër të kualifikimit të vijueshëm profesional;
  - c) Shqyrtimin e kërkesave të anëtarëve për t'u regjistruar, pezulluar ose çregjistruar nga programet e kualifikimit të vijueshëm profesional;
  - d) Organizimin e testimit të njohurive të marra gjatë kualifikimeve të vijueshme;
  - e) Lëshimin e dëshmimeve dhe vërtetimeve për kryerjen e programeve/aktiviteteve të KVP;
  - f) Verifikimin dhe vlerësimin rast pas rasti nëse KM-të përmbushin detyrimet e kualifikimit të vijueshëm profesional;
  - g) Mbikëqyrjen dhe procesin e vlerësimit të KM-ve për kurset, trajnimet dhe programet e ndjekura për kualifikimin e vijueshëm profesional;
  - h) Raportimin pranë Këshillit Drejtues për çështje që lidhen me monitorimin e veprimtarive të kualifikimit të vijueshëm profesional brenda SHKFSH;
  - i) Propozimin pranë Këshillit Drejtues për miratimin e tarifave të aplikueshme për aktivitete të veçanta të kualifikimit të vijueshëm profesional;
  - j) Nxjerr udhëzime dhe këshilla për përshtatshmërinë e kurseve dhe programeve sipas nevojave specifike dhe individuale të KM-ve;

- k) Verifikimin e përshtatshmërisë së kurseve dhe trajnimeve të ndjekur nga anëtarët pranë institucioneve të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera profesionale;
- l) Miratimin e formateve të regjistrimit të KVP-ve në përputhje me këtë rregullore;
- m) Përbushjen e detyrave të tjera të parashikuara në këtë rregullore.

## **Neni 6**

### **Funksionimi i Komisionit të Kualifikimit të Vijueshëm**

1. Komisioni mbledhet në ambientet e SH.K.F.SH. minimalisht një herë në javë, në datën e njoftuar nga Kryetari, dhe sa herë kërkohet prej tij.
2. Komisionit i caktohet një hapësirë e përshtatshme në zyrat e Shoqatës për përbushjen e detyrave të veta dhe asistohet nga sekretaria e Shoqatës, duke paraqitur kërkesë për suport dhe ndihmë teknike dhe materiale pranë Drejtorit Ekzekutiv të Shoqatës.
3. Mbledhjet drejtohen nga Kryetari i Komisionit dhe në mungesë të këtij, drejtohen nga njëri prej anëtarëve.
4. Mbledhjet janë të vlefshme nëse të pranishëm janë më shumë se gjysma e anëtarëve të Komisionit të Kualifikimit, të cilët marrin vendime për të gjitha çështjet që janë në kompetencë të tyre.
5. Në mbledhjet e Komitetit shqyrtohen përshtatshmëria e programeve të zbatueshme për KVP, të personave të përfshirë në mësimdhënie dhe trajnime, çështjet që lidhen me pjesëmarrjen, regjistrimin, pezullimin apo përjashtimin e KM në kurset dhe programet e KVP dhe çdo çështje tjetër e veprimtarisë së Komisionit.
6. Kryetari i Komisionit mban kontakte dhe komunikim të vazhdueshëm me Këshillin Drejtues dhe Drejtorin Ekzekutiv, duke i informuar ata mbi mbarëvajtjen e KVP të anëtarëve.

## **Neni 7**

### **Lirimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Komisionit të Kualifikimit të Vijueshëm**

1. Anëtari i Komisionit të Kualifikimit të Vijueshëm lirohet nga detyra rastet kur:
  - a) mbaron mandati;
  - b) jep dorëheqjen;
  - c) çregjistrohet nga regjistri publik, ose ka pezulluar përkohësisht ushtrimin e veprimtarisë si kontabilist i miratuar;

2. Këshilli Drejtues i SH.K.F.SH. ka të drejtë të shkarkojë një anëtar të Komisionit të Kualifikimit të Vijueshëm, kur:
  - a) nuk merr pjesë, pa arsye, në mbledhjet e Komisionit për më shumë se shtatë herë radhazi;
  - b) veprimet apo mosveprimet e tij kanë dëmtuar rëndë veprimtarinë edukuese dhe të kualifikimit të vijueshëm dhe emrin e SH.K.F.SH.;
  - c) nuk përmbush funksionet e parashikuara nga ligji dhe kjo rregullore;
  - d) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale;
  - e) për shkaqe sëmundjesh fizike ose mendore, gjë që i bën të paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara;
  - f) për shkelje të kuadrit rregullator në fuqi.
3. Këshilli Drejtues, në rastet kur anëtari i Komisionit të Kualifikimit të Vijueshëm lirohet, shkarkohet, dorëhiqet apo vdes, duhet të caktojë një zëvendësues, brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh pune, duke filluar nga data e njoftimit të liritimit, shkarkimit, dorëheqjes apo vdekjes, në përputhje me procedurat e përzgjedhjes.
4. Mandati (katërvjeçar) i zëvendësuesit llogaritet nga dita e emërimit të tij nga Këshilli Drejtues sipas pikës 3 më sipër.

### **Neni 8**

#### **Shpërblimi i anëtareve të Komisionit të Kualifikimit të Vijueshëm**

1. Anëtarët e Komisionit të Kualifikimit të Vijueshëm kanë të drejtën e shpërblimit dhe të rimbursimit të shpenzimeve në masën e përcaktuar nga Këshilli Drejtues.
2. Masa e shpërblimit mund të ndryshojë në varësi të rasteve të shqyrtuara. Shpërblimi i Kryetarit të Komisionit të Kualifikimit të Vijueshëm është më e lartë se ai i anëtarit të këtij Komiteti.

### **Neni 9**

#### **Përgjegjësitë dhe detyrat e Këshillit Drejtues**

1. Këshilli Drejtues i SH.K.F.SH. miraton politikat e edukimit të vijueshëm që hartohen nga Komisioni i Kualifikimit të Vijueshëm dhe tarifatat e aplikueshme për aktivitete të veçanta të kualifikimit të vijueshëm profesional.
2. Bazuar në propozimet e Komisionit të Kualifikimit të Vijueshëm Profesional, Këshilli Drejtues miraton mënyrën e organizimit të KVP dhe mënyrat e monitorimit të ndjekjes dhe përmbushjes së programeve të KVP prej KM-ve si dhe monitorimin e procedurës së vlerësimit dhe testimit individual të kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve KM të Shoqatës.

3. Si pjesë e procesit të vlerësimit, bazuar në propozimet e Komisionit të Kualifikimit, Këshilli Drejtues miraton mënyrat e organizimit të testimit të njohurive të marra gjatë kualifikimeve të vijueshme, i cili duhet të bëhet jo më shpesh se një herë në tre vjet dhe jo më rrallë se një herë në pesë vjet.
4. Këshilli Drejtues asiston me informacion dhe çdo formë tjetër Bordin e Mbikëqyrjes Publike kur ky i fundit investohet të inspektojë dhe mbikëqyrë:
  - a) përshtatshmërinë e politikave të SH.K.F.SH. për edukimin e vijueshëm si dhe mënyrën e organizimit,
  - b) përshtatshmërinë e monitorimit dhe të vlerësimit individual të kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve të Shoqatës nga ana e Këshillit dhe strukturave të Shoqatës;
  - c) mënyrën dhe përshtatshmërinë e organizimit të testimit të njohurive të marra gjatë kualifikimeve të vijueshme nga KM-të, i cili duhet të bëhet jo më shpesh se një herë në tre vjet dhe jo më rrallë se një herë në pesë vjet
5. Në përfundim të një procedure të nisur monitorimi si në pikën 2 më sipër, Këshilli Drejtues publikon rezultatet e monitorimit dhe ia dërgon BMP dhe ndjek rekomandimet e këtij të fundit për masat që duhen ndërmarrë për rregullimin e situatës nga Shoqata.
6. Këshilli Drejtues, në përputhje me parashikimet Statutore dhe Rregulloren e Procedimit Disiplinor të SHKFSH, i propozon Bordit të Mbikëqyrjes Publike pezullimin e ushtrimit të profesionit nga kontabilisti i miratuar, që nuk ka arritur të përfundojnë me sukses kualifikimin e vijueshëm të detyrueshëm, apo çregjistrimin e kontabilistëve të miratuar, të cilët kanë depozituar vërtetime apo dokumente të pavërteta për kryerjen e kurseve të kualifikimit të vazhdueshëm. Këshilli Drejtues sigurohet që propozimet e BMP zbatohen rregullisht nga SH.K.F.SH.
7. Kur BMP merr vendim si në pikën 6 më sipër, Këshilli Drejtues merr masat që Komiteti i Regjistrimit të Shoqatës të reflektojë ndryshimet përkatëse në Regjistrin Publik të mbajtur nga SH.K.F.SH.

### **Neni 10**

#### **Rregulla të përgjithshme të KVP**

1. Çdo anëtar KM i Shoqatës, qoftë KMA apo KMJ, është i detyruar t'i nënshtrohet çdo vit kualifikimit të vijueshëm profesion sipas programeve të përzgjedhura dhe të miratuara nga Komisioni i Kualifikimit të Vijueshëm.
2. Numri i orëve që një anëtar KM i nënshtrohet KVP gjatë një viti nuk mund të jetë më pak se 40 orë. Një aktivitet i vetëm i përsëritur nuk llogaritet si aktivitet më vete dhe nuk llogaritet

në numrin e orëve që duhet të plotësojë KM për përmbushjen e detyrimit të KVP të përvitshëm.

3. Testimi i njohurive të marra gjatë kualifikimeve të vijueshme organizohet nga Komisioni i Kualifikimit të Vijueshëm dhe bëhet jo më shpesh se një herë në tre vjet dhe jo më rrallë se një herë në pesë vjet.
4. KM-ja që i nënshtrohet EVP duhet të tregojë vetë kujdes në përzgjedhjen e programeve dhe kurseve që i shërbejnë formimit të tij profesional të vazhdueshëm dhe nevojave të veta që lidhen me veprimtarinë profesionale. Për këtë, Komisioni i Kualifikimit nxjerr udhëzime dhe rekomandime për anëtarët KM që i nënshtrohen KVP.
5. Mospërmbushja e detyrimeve të kualifikimit të vijueshëm është kusht për mosregjistrimin e kontabilistëve të miratuar në Regjistrin Publik të SH.K.F.SH. për të gjithë vitin pasardhës, dhe për të cilin humbet të drejtën e ushtrimit të profesionit.
6. Anëtari i tërhequr përkohësisht nga ushtrimi i profesionit mund të kërkojë reregjistrimin e tij. Reregjistrimi nga Komiteti i Regjistrimit bëhet nëse KM ka përmbushur të gjitha detyrimet e kualifikimit të vijueshëm profesional edhe gjatë kohës kur ai nuk e ka ushtruar profesionin.

### **Neni 11**

#### **Etika profesionale**

1. Pavarësisht parashikimeve në nenin 10, të gjithë anëtarët duhet të ndërmarrin një minimum prej 4 orësh trajnim në etikë çdo 5 vjet sipas programeve dhe trajnimeve të SH.K.F.SH. në këtë fushë, të cilat mbartin frymën e Kodit të Etikës të IFAC dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare.

### **Neni 12**

#### **Kurrikulat e KVP**

1. Duke pasur parasysh gamën e larmishme të aktiviteteve/programeve që anëtarët ndërmarrin, nuk është e mundur të përcaktohet një kurrikulë e përbashkët e PKV-së. Përgjegjësia qëndron te vetë KM që i nënshtrohet KVP që të zgjedhë aktivitetet dhe disiplinat e përshtatshme të zhvillimit profesional që gjykojnë se u shërben më mirë nevojave për përmirësim dhe kontribuojnë në formim cilësor të aftësive të tyre profesionale.



2. Komisioni i Kualifikimit të Vijueshëm asiston KM-të me këshilla dhe udhëzime të publikuara në faqen e SH.K.F.SH. ose të shpërndara për anëtarët në forma të tjera të përshtatshme.
3. KVP nuk kufizohet në kurset e ofruara në fushën e kontabilitetit dhe financiare. Programet e zgjedhura të KVP-ve mund të lidhen me çdo kompetencë që është e rëndësishme për punën aktuale ose të ardhshme të kontabilistit të miratuar.

### **Neni 13** **KVP e verifikueshme**

1. KVP-të e verifikueshme përfshijnë aktivitetet dhe veprimtaritë e të mësuarit për edukimin e vijueshëm personal, realizimi i të cilave mund të verifikohet objektivisht nga strukturat kompetente sipas kësaj rregulloreje.
2. KVP-të e verifikueshme përmbajnë mësimdhënien nga specialistë kompetentë dhe aktivitete të tjera që mund të përfshijnë dhënien e shërbimit në një komitet teknik, shkrimin e artikujve teknikë ose prezantimin/mësimdhënien në kurse apo trajnime.
3. Në mënyrë udhëzuese, por jo kufizuese, KVP-të e verifikueshme mund të përfshijnë aktivitetet e mëposhtme:
  - a) kurse të organizuara nga Shoqata nëpërmjet ekspertëve të përzgjedhur;
  - b) kurse, seminare ose workshop-e të organizuara nga SHKFSH;
  - c) trajnime nga organizata të tjera profesionale, institucione të arsimit të lartë ose shoqëri kontabiliteti prestigjioze.
  - d) prezantim dhe mësim distancë me mjete të verifikueshme dhe të sigurta për shkëmbimin e informacionit.
  - e) pjesëmarrja konferenca - lokale dhe ndërkombëtare;
  - f) kurse të tjera të strukturuar, me pjesëmarrjen e institucioneve të referuar në pikat më sipër;
  - g) shërbimi në një komision teknik;
  - h) botimi i punimeve profesionale, akademike, artikujve, hulumtimeve dhe botimeve të tjera që kanë lidhje me fushën e kontabilitetit apo fushave të lidhura;
  - i) pjesëmarrja si folës në konferenca, seanca informimi dhe grupe diskutimi;

- j) mësimdhënie në sesione ose kurse të trajnimit.

#### **Neni 14**

#### **Monitorimi i përmbushjes së detyrimit të KVP**

1. Komisioni i Kualifikimit monitoron pjesëmarrjen e anëtarëve në aktivitetet e KVP, që organizohen nga Shoqata apo institucione të tjera të njohura dhe sigurohet që prej tyre të përmbushen orët e nevojshme vjetore për KVP.
2. Gjetjet e Komisionit sipas pikës 1 i raportohen pranë Këshillit Drejtues për çdo tremujor, brenda javës së parë të tremujorit pasardhës.

#### **Neni 15**

#### **Regjistrimi i KVP-ve**

1. SH.K.F.SH. mban një regjistër të veçantë lidhur me kryerjen e procesit të edukimit të vijueshëm profesional për secilin nga anëtarët e tyre ose anëtarë të organizatave të tjera profesionale kur kjo është e parashikuar në memorandume apo marrëveshje bashkëpunimi, apo parashikohet në ligj, apo në rregulloret e zbatueshme.
2. Për secilin KM, në regjistër evidentohen, minimalisht, të dhëna në lidhje me:
  - a) orët e trajnimit;
  - b) datën e kryerjes së trajnimit,
  - c) datën e regjistrimit përkatës,
  - d) modulet e trajtuara,
  - e) vlerësimi/testimi i njohurive të marra gjatë KVP (të cilat mund të jenë subjekt i mbikëqyrjes së BMP-së)
  - f) prezantuesin e veprimtarisë mësimdhënëse/trajnuese;
  - g) numri i orëve që i atribuohet aktivitetit edukues;
  - h) detajet e rëndësisë së aktivitetit të mësuarit për zhvillimin e tanishme apo të ardhshme profesionale e kandidatit;
3. Çdo aktivitet i zhvilluar në kuadër të kualifikimit të vijueshëm profesional të një KM-je regjistrohet dhe përmban detajet e mësimore të ndërmarra për veprimtarinë përkatëse. Komisioni i Kualifikimit të Vijueshëm është përgjegjës për mbajtjen e regjistrimeve dhe për lëshimin e vërtetimeve në lidhje me këto regjistrime.

### **Neni 16**

#### **Dëshmitë që lidhen me Procesin e Edukimit të Vijueshëm**

1. Për të vërtetuar kryerjen e kurseve vjetore të edukimit të vijueshëm dhe përmbushjen e orëve të detyrueshme, Shoqata, nëpërmjet Komisionit të Kualifikimit të Vijueshëm, pajis KM me një dëshmi, e cila tregon orët e kryera dhe modulet e trajtuara në programin e edukimit të vijueshëm.
2. Përmbajtja e dokumentit që lëshohet si dëshmi për kryerjen e kursit të edukimit të vijueshëm propozohet nga Komisioni i Kualifikimit dhe miratohet nga Këshilli Drejtues.
3. Dokumenti duhet të përmbajë elementë që japin informacion ku përfshihen orët e trajnimit, datat e kryerjes së këtij trajnimi, data e lëshimit të dokumentit, modulet e trajtuara dhe një vlerësim për KM lidhur me përvetësimin e njohurive. Gjithashtu, dokumenti duhet të përmbajë informacion ku përfshihen së paku personat përgjegjës për nënshkrimin e dokumentit, nënshkrimet e personave përgjegjës së bashku me vulën e institucionit, si dhe numri rendor i dokumentit.
4. KM-të ruajnë të gjitha dëshmitë e përfituara për realizimin e programeve të edukimit të vijueshëm për një periudhë minimale prej pesë vjetësh nga përfundimi i vitit përkatës të kualifikimit të detyrueshëm dhe kanë detyrimin t'i bëjnë ato të të disponueshme nëse kërkohen për qëllime monitorimi apo për qëllime të tjera të Shoqatës.

### **Neni 17**

#### **Verifikim i përmbushjes së aktivitetit përkatës të KVP-së**

1. Verifikimi i realizimit të veprimtarisë së KVP-së kryhet nëpërmjet:
  - a) Referimit në të dhënat e frekuentimit të kurseve/aktiviteteve, formularët e regjistrimit apo konfirmimin e regjistrimit në një aktivitet të edukimit të vijueshëm;
  - b) vlerësimit në testime apo vlerësimi i pavarur nga një individ kompetent që ka prezantuar një aktivitet të të mësuarit;
  - c) konfirmimeve nga një instruktor, mentor ose tutor për pjesëmarrjen në një aktivitet mësimor;
  - d) vërtetimeve/konfirmimeve nga një institucion i arsimit të lartë apo shoqëri kontabiliteti, të njohur nga Komisioni i Kualifikimit për pjesëmarrjen në një program të KVP,
  - e) punëve të publikuar kërkimore të paraqitura;

- f) konfirmimit nga anëtarët e komisioneve (ose Sekretariatit) për pjesëmarrjen në një komision teknik; dhe
- g) çdo forme tjetër të aprovuar nga Këshilli Drejtues

### **Neni 18**

#### **KVP pranë institucioneve dhe organizatave të tjera**

1. Përveç organizimit nga SH.K.F.SH., kurset për kualifikimin e vijueshëm profesional mund të organizohen edhe nga:
  - a) institucione të arsimit të lartë;
  - b) shoqëri prestigjioze të kontabilitetit, të cilat kanë kapacitete për të organizuar kualifikimin për të punësuarit e vet.
2. Kurset dhe aktivitetet e kualifikimit të vijueshëm profesional njihen nga Shoqata kur institucionet e arsimit të lartë dhe punëdhënësit e përmendur në pikën 1 të këtij neni kanë marrë pëlqimin e BMP për organizimin e kurseve dhe aktiviteteve të KVP.
3. Programi i kualifikimit të vijueshëm të zhvilluar nga subjektet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni duhet të ketë të paktën 50 për qind të programit të njëjtë me programin përkatës të SH.K.F.SH. Pajtueshmëria e parashikuar në paragrafin më sipër bëhet Komisioni i Kualifikimit të Vijueshëm.
4. Për kurset/aktivitetet e zhvilluara pranë subjekteve të përmendura në pikën 1, anëtari ka detyrimin të dorëzojë pranë Komisionit të Kualifikimit vërtetimin e realizimit të KVP-së në origjinal ose kopje të noterizuar.

### **Neni 19**

#### **Të ardhurat nga organizimi dhe testimi i aktiviteteve të KVP**

1. Anëtarët që ndjekin aktivitet e KVP të organizuara nga Shoqata dorëzojnë pranë Komisionit të Kualifikimit vërtetimet përkatëse për realizimin e pagesave përkatëse të aplikueshme për ndjekjen e aktivitetit.
2. Të ardhurat nga veprimtaritë e realizuara në kuadrin e kualifikimit të vijueshëm të anëtarëve, të tilla si, të ardhura nga publikimi i materialeve, kualifikimi i stazhierëve dhe nga ndjekja

dhe testimi i aktiviteteve të kualifikimit të vijueshëm profesional, administrohen nga Drejtori Ekzekutiv.